

VENDIM
Nr.597, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA KUMAN, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kuman, të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 1 (një), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kuman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMIJLARI PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE
(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Komuna: Kuman Fusha e përdorimit të pronës: pyll										
Nr.rend.	Nr. INV sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullusore (E.P.K)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Nr. ngas.	Destinacioni	Sip.në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioi, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	41	Ek py Lumi Seman 2	Pylli Luarit	15	Sip me bimësi pyjore	1.8	Kullotë	M.M.P.A.U	D.SH.P.Fier	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Kuman

Lidhja nr.1

[illegible]